



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 01, datë 14.06.2016

PËR

MIRATIMIN E PLANIT TË PËRGJITHSHËM KOMBËTAR TË TERRITORIT

Në mbështetje të neneve 7, 8, 16, 25 dhe 58 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, të Vendimit Nr. 671, datë 29.07.2015 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, të Vendimit Nr. 1, datë 18.10.2013 të Këshillit Kombëtar të Territorit “Për miratimin e kërkesës për marrjen e Nismës për hartimin e Planit të Përgjithshëm Kombëtar”, si dhe Vendimit Nr. 1097, datë 28.12.2015 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozimin e Ministrisë së Zhvillimit Urban, Këshilli Kombëtar i Territorit,


VENDOSI:

1. Miratimin e “Planit të Përgjithshëm Kombëtar të Territorit”, pjesë e të cilit janë dokumentet e mëposhtëm:
 - a) Relacioni i Planit;
 - b) Materiali hartografik:
 - i. Harta e Sistemit Urban;
 - ii. Harta e Sistemit Natyror;
 - iii. Harta e Sistemit Bujqësor;
 - iv. Harta e Sistemit Ujor;
 - v. Harta e Sistemit Infrastruktural – Transporti;
 - vi. Harta e Sistemit Infrastruktural – Energjia dhe Industria;
 - vii. Harta e Zonave me Rëndësi Kombëtare në Planifikim.
2. Miratimin e Çështjeve dhe Zonave të Rëndësisë Kombëtare të propozuara nga Plani i Përgjithshëm Kombëtar i Territorit.
3. Autoriteti përgjegjës për miratimin e Planeve të Detajuara për Zonat me Rëndësi Kombëtare është Këshilli Kombëtar i Territorit, me propozim të Ministrit përgjegjës dhe/ose atij përgjegjës për zhvillimin urban.

4. Gjatë hartimit të planeve sektoriale kombëtare, planeve të detajuara për zona të rëndësisë kombëtare, planeve sektoriale në nivel qarku, planeve të përgjithshme vendore, projekteve strategjike dhe pilot të zhvillimit, si dhe çdo projekti për zhvillimin e territorit, autoritetet përgjegjëse të planifikimit dhe zhvillimit duhet të bazohen në kuadrin referues të detyrueshëm të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi dhe nga Plani i Përgjithshëm Kombëtar i Territorit.
5. Ngarkohen të gjithë autoritetet përgjegjëse të planifikimit dhe zhvillimit të territorit për zbatimin e Planit të Përgjithshëm Kombëtar të Territorit.
6. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit për monitorimin e zbatimit të PPK-së së Territorit dhe për kontrollin e përputhshmërisë së dokumenteve të planifikimit që hartohen nga autoritetet përgjegjëse me përcaktimet e Planit të Përgjithshëm Kombëtar të Territorit.
7. Ngarkohet Ministria e Zhvillimit Urban për ndjekjen e procedurës ligjore me qëllim miratimin e dokumentit të Planit të Përgjithshëm Kombëtar të Territorit në Këshillin e Ministrave.
8. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI


EDI RAMA



ZËVENDËS KRYETAR I KKT

EGLANTINA GJERMEZI

MINISTER I ZHVILLIMIT URBAN



A circular blue ink stamp from the Ministry of Urban Development of the Republic of Albania. The text around the perimeter reads "REPUBLIKA E SHQIPRIE - ZHVILLIMI URBAN" and "MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN TIRANE". The stamp is partially obscured by a handwritten signature in blue ink.

SEKRETAR I KKT

LEDIA TOTA

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT



A circular blue ink stamp from the Agency for Territorial Development of the Republic of Albania. The text around the perimeter reads "REPUBLIKA E SHQIPRIE - ZHVILLIMI URBAN" and "AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT TIRANE". The stamp is partially obscured by a handwritten signature in blue ink.